Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr.Br. 795/20
Datë/Datum. 28.10.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.795/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina- Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T.SH "Unisoft" - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me printer për ID kartela me ngjyra", me nr. të prokurimit 701-20-5036-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Qendra Klinike Universitare e Kosovës, më datë: 27.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH "Unisoft" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me printer për ID kartela me ngjyra", me nr. të prokurimit: 701-20-5036-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

II. **ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me printer për ID kartela me ngjyra", me nr. të prokurimit: 701-20-5036-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Qendra Klinike Universitare e Kosovës dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.T.SH "Unisoft" - Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.T.SH "Unisoft" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 12.10.2020 me nr. 795/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me printer për ID kartela me ngjyra", me nr. të prokurimit: 701-20-5036-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Qendra Klinike Universitare e Kosovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 16.10.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit ne detaje të procedurës së tenderit si dhe shqyrtimit të pretendimit ankimorë të OE dhe dokumentacionit në dispozicion të kësaj procedure të prokurimit, eksperti shqyrtues jep këtë mendim:

Pretendimi ankimorë i OE është ndaj anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe eliminimit të ofertës së tij:

AK – Qendra Klinike universitare e Kosove ne FDT tek kapaciteti mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar si në vijim:

III.4. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa 1. Distributor i Autorizuar nga Prodhuesi I(DAF)	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 1: Të dëshmohet me Distributorë i Autorizuar nga prodhuesi (DAF)

AK – Qendra Klinike Universitare e Kosovës në raportin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka cekur se operatori ekonomik N.T.SH. "Unisoft" nuk plotëson kriterin e autorizimit të prodhuesit DAF – Distributor Authorization Form.

Gjate analizimit të ofertës shihet se Operatori Ekonomik në ofertën e tyre ka prezantuar autorizimin e lëshuar nga prodhuesi Zebra Partner Connect si dhe autorizimin nga distributori SCANSOURCE EUROPE.

Më datë 21.10.2020 AK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës në bazë të Letrës standarde për sqarime ka

kërkuar informacione shtesë nga ana e operatorit ekonomik N.T.SH. "UNISOFT" lidhur me autorizimin e prodhuesit apo distributorit.

Operatori ekonomik me anë të shkresës së datës 23.10.2020 ka kthyer përgjigje tek AK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës ku ka sqaruar kërkesën e AK dhe ka bashkangjitur edhe certifikatat e prodhuesit dhe distributorit si në vijim:

Certificate of Autorization nga prodhuesi "Zebra Partner Connect" (prodhues i printerëve të ndryshëm)

Autorizim DAF – Distributor Authorization Form nga "Scansource Europe" i cili është distributor i prodhuesit "Zebra Partner Connect".

Operatori ekonomik ofertues ka dorëzuar dy (2) autorizime të Prodhuesit (MAF) siç është "Zebra Partner Connect" dhe të distributorit (DAF), siç është "Scansource Europe" të cilat kanë të bëjnë me pajisjet e kërkuara sipas specifikimit teknik në DT, Aneksit nr. 1 të vendosur nga ana e Autoriteti Kontraktues.

Edhe kërkimet në internet për prodhuesin "Zebra Partner Connect" dhe distributorin e prodhuesit "Scansource Europe" sqarojnë dhe dëshmojnë këtë se "Scansource Europe" është distributor për Europë dhe partner i prodhuesit "Zebra Partner Connect" autorizimin e të cilit ka OE. NTSH UNISOFT.

Linçet ne internet:

https://ëëë.zebra.com/us/en/partners/partner-application-locator.html

https://ëëë.scansource.eu/en/technology/autoidpos/brands/zebra

https://ëëë.zebra.com/us/en/products/printers/card.html#mainpar-productseries_fb0e

Andaj konsideroj se dokumenti i kërkuar përmbushë kërkesat e AK dhe rrjedhimisht pretendimi ankimorë i operatorit ekonomik është i bazuar.

Andaj Autoriteti kontraktues me rastin e anulimit të këtij aktiviteti te prokurimit dhe eliminimin e operatorit ekonomik ka vepruar në kundërshtim me Nenin 59 dhe 62 të LPP.

Gjatë procesit te rivlerësimit rekomandojmë që AK të ketë parasysh edhe Nenin 1, Neni 7 dhe Nenin 60 të LPP-së dhe interesi e AK për zgjedhjen e aktivitetit te prokurimi.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 16.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimet ankimore kanë të bëjnë ndaj anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe eliminimit të ofertës të OE ankues. Autoriteti kontraktues Qendra Klinike Universitare e Kosovës në FDT tek kapaciteti mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar: Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1. Distributor i Autorizuar nga Prodhuesi I(DAF)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: Të dëshmohet me Distributorë i Autorizuar nga prodhuesi (DAF)

Autoriteti kontraktues QKUK në raportin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka cekur se operatori ekonomik N.T.SH. "Unisoft" nuk plotëson kriterin e autorizimit të prodhuesit DAF – Distributor Authorization Form.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se gjatë analizimit të ofertës të OE ankues shihet se në ofertë ka prezantuar autorizimin e lëshuar nga prodhuesi Zebra Partner Connect si dhe autorizimin nga distributori SCANSOURCE EUROPE. Ndërsa, më datë 21.10.2020 AK në bazë të Letrës standarde për sqarime ka kërkuar informacione shtesë nga ana e operatorit ekonomik N.T.SH. "UNISOFT" lidhur me autorizimin e prodhuesit apo distributorit.

Operatori ekonomik me anë të shkresës së datës 23.10.2020 ka kthyer përgjigje tek AK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, ku ka sqaruar kërkesën e AK dhe ka bashkangjitur edhe certifikatat e prodhuesit dhe distributorit si në vijim:

Certificate of Autorization nga prodhuesi "Zebra Partner Connect" (prodhues i printerëve të ndryshëm)

Autorizim DAF – Distributor Authorization Form nga "Scansource Europe" i cili është distributor i prodhuesit "Zebra Partner Connect".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ofertues ka dorëzuar dy (2) autorizime të Prodhuesit (MAF) siç është "Zebra Partner Connect" dhe të distributorit (DAF), siç është "Scansource Europe" të cilat kanë të bëjnë me pajisjet e kërkuara sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit, Aneksit nr. 1 të vendosur nga ana e Autoriteti Kontraktues. Edhe kërkimet në internet për prodhuesin "Zebra Partner Connect" dhe distributorin e prodhuesit "Scansource Europe" sqarojnë dhe

dëshmojnë këtë se "Scansource Europe" është distributor për Evropë dhe partner i prodhuesit "Zebra Partner Connect" autorizimin e të cilit ka OE. NTSH UNISOFT.

Linçet ne internet:

https://ëëë.zebra.com/us/en/partners/partner-application-locator.html

https://ëëë.scansource.eu/en/technology/autoidpos/brands/zebra

https://ëëë.zebra.com/us/en/products/printers/card.html#mainpar-productseries_fb0e

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se dokumenti i kërkuar përmbushë kërkesat e AK dhe rrjedhimisht pretendimi ankimorë i operatorit ekonomik është i bazuar. Andaj Autoriteti kontraktues me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe eliminimin e operatorit ekonomik ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe 62 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është bëre në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues qe ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimin e ofertave ta bëjë konform nenit 59 të LPP-së, duke u bazuar ne kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- QKUK

1x1 OE - N.T.SH "Unisoft" – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.